



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

***Dokument
parlamentar***

Tiranë më 02 .04. 2019

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
PËR VITIN 2018**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 19.3.2019, zhvilloi seancën dëgjimore për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës, për vitin 2018. Kjo seancë dëgjimore u bë bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, dhe nenin 24, gërma e, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

Në mbledhjen e komisionit ishte e pranishme Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës Znj. Juliana Latifi dhe përfaqësues të tjerë të Institucionit. Znj. Latifi paraqiti drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit të mëparshëm si dhe prioritetet për vitin 2019.

II. Performanca e Institucionit

Autoriteti i Konkurrencës edhe gjatë vitit 2018 ka ushtruar veprimtarinë në përmbushje të misionit të tij për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, në dobi të rritjes ekonomike dhe mirëqenies së konsumatorëve. Aktiviteti i tij është përqendruar në zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese, kontrollin e përqendrimeve si dhe vlerësimin e një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore.

Ky aktivitet, gjatë vitit 2018, u konkretizua në **87 vendime** (gati dy herë më tepër se viti i kaluar) të marra nga ana e Komisionit të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2018 u bë i mundur ekzekutimi i vendimeve aktuale dhe të hershme, të marra nga

Komisioni i Konkurrencës duke arkëtuar në buxhetin e shtetit shumën e ardhur nga vjelja e gjobave prej **269,104,486 lekë**.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian i cili përbën një nga prioritetet e Autoritetit, dhe në përmbushje të akteve të planifikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2018-2020, për kapitullin “Politika e Konkurrencës”, AK, realizoi përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me acquis të BE, me dy akte sekondare.

III. Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit

Rekomandimet e dhëna nga Kuvendi janë përmbushur nga Autoriteti i Konkurrencës përse i përket aktivitetit gjatë vitit 2018.

Është forcuar bashkëpunimi me organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore. Janë kryer marrëveshje të reja bashkëpunimi me disa ente rregullatore, të cilat në veprimtarinë e tyre diktojnë konkurrencën në tregjet respektive që ato rregullojnë si: AKEP, ERRU, AMA, DPPP, Posta Shqiptare.

Duke marrë parasysh ndikimin që ka legjislacioni mbi parametrat e konkurrencës, vlerësimet *ex-ante*, dhe *ex-post* të akteve ligjore, akteve nënligjore dhe akteve të tjera normative kanë qenë gjithashtu pjesë e rëndësishme e punës së Autoritetit, ku mbizotërojnë 40 akte të vlerësuara për sektorin e energjisë të dërguara për mendim nga ERE.

Autoriteti ka vazhduar mbikëqyrjen e tregjeve ku ushtrojnë veprimtari ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme dhe me fuqi tregu në rritje si dhe ka kryer veçanërisht hetime ndaj ndërmarrjeve, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive, konkretisht:

-Tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre

-Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit

- Tirana Airport Partners” SHPK

Gjatë vitit 2018 është bërë i mundur forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative nëpërmjet shtimit të numrit të inspektorëve në drejtoritë teknike në strukturën e AK-së, të miratuar nga Kuvendi.

IV. Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës

Gjatë vitit 2018 Autoriteti ka dyfishuar numrin e vendimeve për dhënie rekomandimesh ndaj organeve të administratës shtetërore, enteve rregullatore dhe institucioneve të tjera të pavarura në ruajtje të mjedisit konkurrues dhe nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Nga 19 rekomandime në total që ka dhënë Komisioni i Konkurrencës, 5 janë të përmbushura, 8 në proces, 1 pjesërisht i përmbushur dhe 5 të papërmbushura.

Marrëveshjet e reja të bashkëpunimit me AKEP, AMA duket se kanë dhënë rezultate pozitive përse i përket përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës në tregjet respektive

që ato mbulojnë, ndërkohë që, bie në sy problematika e përsëritur me Entin Rregullator të Ujit me 4 rekomandime të papërmblushura dhe asnjë të përmblushur.

V. Diskutimi në komision

Relatori, i caktuar nga Komisioni për këtë çështje Z. Rolant Xhelilaj, paraqiti një informacion me vlerësimet e tij për veprimtarinë njëvjeçare të këtij institucioni si dhe disa rekomandime për përmirësimin e punës gjatë vitit në vazhdim. Më pas kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës iu përgjigj pyetjeve të deputetëve të pranishëm.

Kryetari i Komisionit të Ekonomisë Z. Arben Ahmetaj shprehu qëndrimin e tij duke theksuar se puna e Autoritetit të Konkurrencës duhet të ngrihet në një nivel të ri, duke u fokusuar në fenomene që krijojnë standarde të reja. Ai u ndal kryesisht te problematikat që vijnë nga tregu i transportit ajror, tregu i medikamenteve dhe tregu bankar si dhe rolin e Autoritetit në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg me fokus dëmin apo përfitimin real të konsumatorit publik. Z. Anastas Angjeli u shpreh se kishte nevojë për rishikim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar për një përputhje sa më të plotë me standartet e BE-së dhe kushtet e reja të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

VI. Përfundime

Në datën 02 prill 2019, Komisioni miratoi, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, projektrezolutën për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018, në të cilën pasqyroi vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse. Këtë projektrezolutë, sipas variantit bashkëlidhur, Komisioni ia paraqet seancës plenare për votim.

RELATOR

ROLANT XHELILAJ

KRYETAR

ARBEN AHMETAJ